


Në sallën e madhe "Arena" në Tetovë, mbi 450 pensionistë janë shodëruar, kanë rinovuar miqësitë e vjetra dhe kanë krijuar të reja, duke dëshmuar se edhe në kohë të këttilla mund dhe dinë të jenë njëri me tjetrin dhe t'i lënë anash barrierat nacionale dhe të gjitha pengesat se kush ciles fe i takon apo cilën gjuhë e flet. Në të vërtetë, takime të këttilla multietnike realizohen tradicionalisht vite më parë në Tetovë dhe në Lidhjen e pensionistëve. Kështu ka qenë dhe kështu do të jetë në këtë asociacion multietnik. Çdo herë të gjithë janë futur në valle dhe është kënduar në të gjitha gjuhët e njerëzve që jetojnë në vendin tonë. Mendimin e njëjtë e ndau edhe kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova, e cila iu drejtua të pranishmëve: "Me të gjitha këto manifestime, në të cilat numri i

SHOQËRIMI TRADICIONAL MULTIETNIK PENSIONISTËT, SHEMBULLI MIRË PËR MIQËSI MULTIETNIKE



pensionistëve është i madh, përforcohet bashkëjetesa, kolektiviteti, pensionistët tejkalojnë vetminë dhe depresionin, dhe janë shembull për generatat e reja se si të jetohet, jo njëri afër tjetrit, por njëri me tjetrin, sepse ajo është e ardhmja jonë", është shprehur kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova.

Siç është tradita, Stojan Skaolov kryetar i Kuvendit dhe Selver Memeti kryetari i SHP Tetovë, në cilësinë e nikoqirëve, kanë përshëndetur të pranishmit në gjuhën magedonase dhe gjuhën shqipe, duke i porositur ata që të ruajnë bashkimin, sepse multietniciteti është pasuri, duke shprehur dëshirën që tradita e miqësisë së përbashkët të vazhdojë edhe gjatë viteve të ardhshme. Mbrëmje tradicionale miqësore me pen-

nionistëve është mbajtur për të 24 herë, edhe në Gostivar, në restorantin "Albis". Në mbrëmjen miqësore morën pjesë rreth 280 pensionistë nga shoqatat: Saraj, Tर्फالixhe dhe Shoqata e pensionistëve të Luftës Shkup, nga Ohri dhe Lidhja e sin-

dikatave të gzyretit të Pogradecit nga Shqipëria. I pari të pranishmit i përshëndeti kryetari i SHP Gostivar, Nijazi Xhelili, nikoqir i mbrëmjes. Ai u dëshiroi mysafirëve shëndet, jetë të gjatë dhe shumë vite të marrin pjesë në miqësi të këttilla. Të pranishmit përshëndeti edhe kryetarja e Aktivit të pensionistëve pranë SHP Gostivar, Vadije Zendeji: "Gëzimi ndihet në shumë kur ndahet Gjени kohë për argëtim dhe të kënaqeni edhe në moshën e tretë. Shoqërohuni me miqtë dhe ruajeni miqësinë sepse kjo bën të ndihemi edhe më


të lumtur. Edhe ne si pensionistë dimë të organizojmë miqësi të këttilla dhe nuk lejojmë që askush të na i ndërpresë dhe minimizojë sukseset dhe rezultatet tona", u shpreh Zendeji.

Të pranishmit i përshëndeti edhe koordinatori i Lidhjes së sin-dikatave të gzyretit të Pogradecit nga Shqipëria, Hajrush Collaku. "Organizimet e këttilla janë të rralja dhe për tu përshëndetur. Dëshiroj që bashkëpunimi ynë të vazhdojë edhe në të ardhmen", u shpreh Collaku.

Në mbrëmjen e pensionistëve u kënduan këngë në të gjitha gjuhët që fliten në këto hapësira dhe janë argëtuar të gjithë së bashku pavarësisht se kush prej nga është. Të gjithë ishin të lumtur dhe të gëzuar, dhe këtë natë do ta mbajnë mend shumë gjatë.


SHP DIBËR DHE QENDRA ZHUPË PËRFUNDIMISHT LEGALIZOHET SHTËPIA E PENSIONISTËVE NË DIBËR

Mosmarëveshjet rreth legalizimit të objektit të pensionistëve të Dibërës si dhe marrëdhëniet e pazgjidhura pronësoro-juridike tanijarë tejkaluar. Udhëheqësja e shtëpisë së pensionistëve në Dibër ka marrë vendimin për legalizim dhe njëkohsisht flitet pronësore me çka vërtetohet se objekti është në pronësi të pensionistëve të Komunave Dibër dhe Qendra Zhupë. "Edhe përkundër shumë probleme në procesin e legalizimit, megjithatë objekti u legalizua. Legalizimi i objektit ka filluar që në vitin 2016. Barrierat me të cilat balafaqohej procesi i legalizimit janë tejkaluar me mbështetjen e kryetarës së Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Magedonisë, Stanka Trajkovska, si dhe me mbështetjen e kryetarit të Komunës së Dibërës, Dr. Hekuran Duka", u shpreh kryetari i Shoqatës së pensionistëve të Dibërës, Xhavit Karpuzi. Objekti ka 470 metra katror dhe përbushetë të gjitha nevojat e



pensionistëve. Ai përmban katin përdhese me objekte për biznes, Klub të pensionistëve, zyre dhe sallatë takimeve për nevojat dhe aktivitetet e shoqatës. Ky objekt është ndërtuar në vitet e 70-ta kur në krye të Dibërës ishte kryetari Abdyll Vojnika, dhe komuna së bashku me institucionet kanë marrë pjesë në ndërtimin e objektit. Në thelb Shtëpia e pensionistëve është ndërtuar me mjete të pensionistëve të Dibërës dhe prandaj objektivist tani kjo ndërtesë është në pronësi të pensionistëve të Komunave Dibër dhe Qendra Zhupë, komunë e cila në atë kohë ishte pjesë e territorit të Dibërës, e njohur si Zhupa e Dibërës.

është në qendër të Dibërës dhe me legalizimin dhe zgjidhjen e problemit me pronësinë e të njëjtëve pen mundësi të ketë efikasitet të rritur ekonomik. Legalizimi i objektit është përshëndetur edhe nga ana e të gjithë pensionistëve dhe nga ana e pushtetit lokal të Dibërës: "Shoqata e pensionistëve Dibër dhe Qendra Zhupë ka mbi 1700 anëtarë, prej të cilëve mbi 400 në Komunën Qendra Zhupë, ku gjithashtu është siguruar Klub për shodërim të pensionistëve. Klubi në Qendrën Zhupë është siguruar me mbështetjen e Komunës Qendra Zhupë, me të cilën shoqata ka bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Në shoqatë janë aktiv tre komisione, edhe atë ai i



shëndetësisë, i sportit dhe rekreacionit dhe i për buxhet dhe financat. Shumë aktiv është edhe Aktiv i pensionistëve që numëron rreth 200 pensioniste. Shoqata merr pjesë në të gjitha aktivitetet lokale, racionale dhe republikane. Bashkëpunimi me Lidhjen e shoqatave të pensionistëve është në nivel shumë të lartë, por shoqata ka bashkëpunim edhe me të gjitha shoqatat në vend si dhe shoqatat nga Pogradeci, Korça dhe Peshkopia e Shqipërisë. Me qëllim që të ofrojë mbështetje për anëtarësinë e vet, shoqata jep me këste dru për ngrohje dhe gjëra të tjera të nevojshme", është shprehur kryetari i shoqatës, Xhavit Karpuzi. (MS)



SHP ÇAIR Fëmijët me nevoja të veçanta në gosti te pensionistet

Një grup mbrojtësish nga Enti për rehabilitim në Fushë Topanë, Qendra ditore për fëmijë dhe të rinj me nevoja të veçanta, më 23 dhjetor të vitit të kaluar, ndërsa me rastin e festave të fund vitit, i vizituan aktivistet e Aktivit të pensionistëve të SHP Çair dhe banorët pranë Shtëpisë së përsosurave të moshuar "Ulka Çopova", dhe me ta u shodëruan rreth një orë. Në sallën e mbushur të Klubit të shtëpisë së pensionistëve, fëmijët u pritën me ëmbëlsira dhe gatime të ndryshme të bëra nga duart e pensionistëve, me qëllim që në këtë mënyrë t'ju zbukuronjë festat e fund vitit. Në takimin falim mbajti Todori Iliev, koordinatori i SHP Çair. Sipas tij, është e nevojshme që të vazhdohet tradita e cila është në iniciativë të Shoqatës, ndërsa qëllimi është të tregohet respekt edhe ndaj kësaj kategorie të gzyretarëve: "Më vjen mirë që kemi mundësi që në këto ditë të fund vitit t'ju mirepresim dhe të shodërohemi me ju. Duam t'ju shohim mes nesh, pensionistëve, ta ndjeni që jeni pjesë e jona, që kujdesemi për ju dhe t'ju dëshirojmë lumturi dhe shëndet në vitin 2020", u shpreh Iliev. Për mikpritjen e mirë, pensionistëve iu falënderua Stojanço Trajkov, instruktor në Entin për rehabilitim, i cili theksoi që për fëmijët me nevoja të veçanta kanë shumë rëndësi këto lloje të takimeve dhe shodërimeve. Në të njëjtën kohë, pensionistëve iu dëshiroi shëndet të mirë dhe shumë takime të ngashme në të ardhmen. Për misionin human gjysheve dhe gjyshtërvë, të cilët u bënë dritën më të bukur, fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta, iu kthyen me buzëqeshje, përfaqëme dhe këngë. Gjatë largimit nga ana e Aktivistëve iu dhuruan edhe pakë me produkte ushqimore. (VP)